

Raport i Audituesit të Pavarur

(Bashkalidhur Pasqyrat Financiare te audituara)

Shoqëria "KLENSI" sh.p.k Tiranë

USHTRIMI MBYLLUR ,ME 31.12.2014

Tirane me , 17/03/2015

Lumturi Brahaj

Eksperte Kontabel e Rregjistruar
Rr: "Asim Vokshi" pl. 13 kat, shk.25, ap.6
Tel: ++3554 2403910, cel.0692158344,
0692069881

RAPORTI I AUDITUSIT TE PAVARUR

Ortakut te vetem te shoqerise "KLENSI" sh.p.k

TIRANE.

I nderuar zoteri.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te shoqerise "KLENSI" sh.p.k , te cilat perbehen nga bilanci kontabel i dates 31.12.2014, pasqyrat perkatese te te ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyren e ndryshimeve ne kapital dhe pasqyren e fluksit te paras per vitin qe eshte mbyllur, si dhe nje permbledhje te metodave te rendesishme kontabel dhe shenimeve te tjera anekse.

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Raportimit Financiar. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqert te pasqyrave financiare pa anomali materiale te shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi , zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtatshme kontabel ; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabel te arsyshme per rrethanat. Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinjon mbi keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin tone.

Ne e kryem auditimin ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te respektojme kerkesat e etikes dhe te planifikojme dhe te kryejme auditimin me qellim qe te marrim nje siguri te arsyshme nese pasqyrat financiare nuk kane anomali materiale.

Auditimi ka te beje me kryerjen e procedurave per te mare evidence auditimi rreth shumave dhe iformacineve te dhene ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditusit, perfshire ketu edhe vlersimin e rreziqeve te anomalive materiale ne pasqyrat financiare si pasoj e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerson keto rreziqe , auditusi mer ne konsiderate kontrollin e brendshem te entitetit mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare ne menyre qe te planifikoje procedura te pershtatshme auditimi ne rrethanat perkatese te entitetit, por jo me qellim qe te shprehe nje opinjon mbi efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit. Auditimi gjithashtu ka te beje me vlersimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe arsyshmerine e çmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi, si dhe me vlersimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme qe evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftushme dhe e pershtatshme per te dhene bazat per opinionin tone te auditimit.

Opinionit.

Sipas opinionit tone pasqyrat financiare japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te gjendjes financiare te shoqerise me 31 Dhjetor 2014, te realitetit te saj financiar dhe te flukseve te saj te parave per vitin e mbyllur ne ate date, ne perputhje me Standartet Kombetare te Raportimit Financiar ne Republiken e Shqiperise.

Tirane , me 17/03/2015.

Adresa:

Eksperte Kontabel e Rregjistruar
Rr. "Asim Vokshi" plli, 13 kat, shk. 25 ap 6
Tel. ++3554 2403910, cel. 0692158344,
0692069881

Eksperte Kontabel e Regjistruar (lic nr. 121)

Lumturi BRAHAJ



Raporti i paraqitur eshte mbeshetur mbi deklarimet bashkangjitur

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. Informacione te pergjitheshme

Shoqeria "KLENSI."sh.p.k është themeluar me date 10.03.2008 dhe është regjistruar ne QKR me date 13.03.2008.

Forma ligjore e shoqerise është. Sh.P.K.

Vlera e kapitalit te shoqerise është 84 000 000 leke e ndare ne 100 aksione me vlere nominale 840 000 leke aksioni.

Shoqeria" KLENSI" ka nje pronare qe zoterojne 100 % te kontributit ne kapital.

Veprimtaria kryesore tregtare e sajë është e percaktuar hollesishte ne aktin e themelimit dhe ne statut.

Aktualishte ajo meret me aktivitet ndertimi.

Selia e Shoqerise është ne Tirane, ne Rr. "Frederik Shiroka"

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2014 është zbatuar formati i SKK-2.

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur , janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin është 15 % nga 10% që ka qenë në ushtrimin e mëparshëm.

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e kostos. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës lineare për ndertesat dhe mbi bazën e vlerës mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Normat e perdorura janë në ndertesat 5 % të vlerës mbetur dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur.

Gjendjet e inventareve

Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimit qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

3 Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 jane si me poshte:

A	A K T I V E T	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2014	Viti Paraardhës 31.12.2013
1	Aktive monetare	512,531	2,922,861	400,667

Gjendjet e llogarive te likujditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njehta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave.

Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes se Shqiperise.

4. Derivate dhe aktive te mbajtura per tregtim.

Shoqeria nuk ka derivate dhe aktive te mbajtura per tregim.

5. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2014 deklarohen si vijon:

A	A K T I V E T	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2014	Viti Paraardhës 31.12.2013
3	Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
(i)	Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	411	77,578,470	73,047,269
(ii)	Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme			
(iii)	Instrumente të tjera borxhi	418	-	-
(iv)	Investime të tjera financiare (Per DELIA ENERGJI)		-	-
	Totali 3	5	77,578,470	73,047,269

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme" jane pasqyruar kerkesat ndaj klienteve per shitjen e mallrave .Lista e tyre analitike i bashkangjitet pasqyrave financiare.

6. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqitet si vijon.

Vlersimi i stokut eshte bere sipas standartit .(skk nr 4)

Shoqeria ka bere inventarin fizik te mallrave dhe disponon listat e inventarve .

A	AKTIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2014	Viti Paraardhës 31.12.2013
4	Inventari			
(i)	Lëndët e para	351	19,751,588	22,174,414
	Totali 4	4	19,751,588	22,174,414

7. Aktive biologjike afat shkurtra nuk ka.

8. Aktive Afat shkurtra te mbajtura per shitje nuk ka.

9. Parapagime dhe shpenzime te shtyra deklarohen si me poshte.

Ketu jane pasqyruar shpenzimet e shtyra ,te cilat lidhen me ndertimin e apartamenteve dhe do te kalojne ne rezultatin respektive ne momentin e shitjes se tyre per siguruar perputhjen e te ardhurave me shpenzimet .

A	AKTIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2014	Viti Paraardhës 31.12.2013
7	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	481,486	782,238,936	682,847,198

10. Aktivet Afatgjata (Investime financiare afatgjata nuk ka)

11. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendja levizjet dhe amortizimi i tyre pasqyrohen ne pasqyren e me Poshte.
Grupimi dhe vlersimi tyre eshte bere i sakte.

A	AKTIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2014	Viti Paraardhës 31.12.2013
2	Aktive afatgjata materiale			
(i)	Toka		-	-
(ii)	Ndërtesa		-	-
(iii)	Makineri dhe pajisje	2134/2183	8,560,631	1,560,631
(iv)	Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)	215	16,183,530	17,078,117
	Totali 2	11	24,744,161	18,638,748

Gjendja dhe ndryshimet e AAM-ve, amortizimet dhe zhvleresimet

	Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesat	Makineri dhe pajisje	Aktivete tjera afatgjata materiale	Totali
A	Kosto e AAM-ve me 01.01.2014	-	-	29,498,502	0	29,498,502
	Shtesat	-	-	7,000,000	0	7,000,000
	Pakesimet	-	-	0	0	0
	Kosto e AAM-ve 31.12.2014	-	-	36,498,502	-	36,498,502
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2014	-	-	10,859,754	0	10,859,754
	Amortizimi ushtrimit	-	-	894,587	0	894,587
	Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	0	0	0
	Amortizimi i AAM-ve 31.12.2014	-	-	11,754,341	-	11,754,341
	Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2014	-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2014	0	0	18,638,748	0	18,638,748
	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2014	0	0	24,744,161	0	24,744,161

Pasqyre llogaritese dhe kontrolli i amortizimit fiskal

1	Amortizimi per gjendjet 01.01.014		0	894,587	0	894,587
2	Korigjimi amort. per daljet 2014				0	0
3	Amortizimi per shtesat 2014			0		0
	Shuma					894,587

12.Aktive biologjike afat gjata nuk ka.

14.Kapitali aksionar I pa paguar nuk ka.

15.Aktive te tjera Afat gjata nuk ka.

16.Detyrime afatshkurtera

16/1.Derivatet nuk ka.

16/2.-Huamarrjet ne banka nuk ka.

Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

16/3. Huat dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2014 paraqiten si vijon:

B	PASIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2014	Viti Paraardhës 31.12.2013
3	Huatë dhe parapagimet			
	(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	401	150,507,912	231,997,903
	(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	421/431/442	317,810	108,121
	(iii) Detyrimet tatimore	444 4573	4,385,178	959,637
	(iv) Hua të tjera	455	23,948,419	28,058,840
	(v) Parapagimet e arkëtuara	488	584,157,078	420,431,594
	Totali 3	16/3	763,316,397	681,556,095

Drejtimi mendon se te gjitha huat dhe parapagimet do te paguhen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

Detyrimet ne monedhe te huaj jan vlersuar me kursin e bankes se Shqiperise te dates 31.12.2014.

“Të pagueshme ndaj furnitorëve” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit.

Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor.

Vlersimi eshte bere fature per fature te mbetur e pa u likujduar.

Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vlersuara realisht.

“Të pagueshme ndaj punonjësve“ perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit dhe detyrimet qe ka per ta ndaj shtetit per sigurime e tatim ne burim deri ne 31.12.2014.

“Detyrimet tatimore perfaqesojne detyrimin per ,tatimin mbi fitim dhe tvsh-ne.te muajit fundit te vitit 2014.

Ne parapagime te arketura eshte pasqyruar dhe ne huat e tjera jane pasqyruar parapagime te bera per shitjet qe do behen ne perfundim te objektit ne ndertim.Gjate vitit ushtrimore eshte realizuar shitja e disa apartamenteve dhe dyqane .

16/4. Grande dhe te ardhura te shtyra nuk ka.

16/5.Provizione afat shkurtra nuk ka.

17. Detyrime afat gjata

17/1. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata jane pasqyruar detyrimet ndaj bankave si me poshte:

B	PASIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2014	Viti Paraardhës 31.12.2013
1	Huatë afatgjata			
	(i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare		19,149,777	29,945,702
	(ii) Bonot e konvertueshme		-	-
	Totali 1		19,149,777	29,945,702

18. KAPITALI

.Kapitalet e veta.

Kapitalet e veta te shoqeris jane te barabarta me fitimet neto te realizuara plus kontributin fillestar.

B	PASIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2014	Viti Paraardhës 31.12.2013
III	KAPITALI			
1	Aksionet e pakicës (përdoret vetëm në pasqyrat financiare të konsoliduara)		-	-
2	Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë mëmë (përdoret vetëm në PF të konsoliduara)			-
3	Kapitali i rregjistruar(aksionar)	101	84,000,000	63,000,000
4	Primi i aksionit		-	-
5	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)		-	-
6	Rezerva statutore		-	-
7	Rezerva ligjore	1071	1,606,499	763,816
8	Rezerva të tjera		-	-
9	Fitimet(humbja) e pashpërndara	108		
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar	109	39,163,343	21,842,683
	TOTALI I KAPITALIT (III)	18	124,769,842	85,606,499

Gjate ushtrimit kontabel ka rritje te kapitaleve te veta per fitimin e realizuar 39,163,343 leke.

19.Fitimi (humbja) e vitit financiar

▪ **Te ardhurat .**

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Referencat Nr.llog.	Viti Raportues 31.12.2014	Viti Paraardhës 31.12.2013
1	Shitjet neto	701,705	202,927,048	280,102,147
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit (Puna e kryer nga njesia ekonomike raportuese përqëllimet e veta e kapitalizuar	702-708...	1,276	1,729
3	Shitje pjesore objektit ne ndertim	787	175,529,494	0
	Totali i të ardhurave	19	378,457,818	280,103,876

Të ardhurat nga shitja e produkteve dhe e shërbimeve të ndërtimit janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja.

Njohja dhe vlerësimi janë bazuar në SNK-9.

▪ **Shpenzimet e veprimtarisë kryesore.**

Paraqitja në pasqyrat financiare është bërë sipas natyrës së tyre.

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Referencat Nr.llog.	Viti Raportues 31.12.2014	Viti Paraardhës 31.12.2013
4	Materialet konsumuara, mallrat dhe shërb.	601-608	(101,499,273)	(118,911,368)
5	Kosto e punës	641-648.	-	-
	Pagat e personelit	641	(6,550,231)	(4,563,925)
	Shpenz. e sigurimit shoqërorë dhe shënd.	644	(984,248)	(647,570)
6	Amortizimet dhe zhvlerësimet	68...	(894,587)	(492,851)
7	Kosto repektive e sipërfaqeve të shitura, të ndërtuara.	686	(168,050,250)	0
8	Shpenzime të tjera	61-63	(53,246,746)	(131,211,603)
8	Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)		(331,225,335)	(255,827,317)

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve të shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë regjistruar me shumën e paguara ose të pagueshme. Kostoja e punësimit, page dhe sigurime shoqërore, është pasqyruar saktësisht si shpenzim me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar.

Gjatë vitit ushtrimor 2014 janë realizuar shitje të sipërfaqeve të ndërtuara në vlerën 175,529,494 leke dhe në shpenzime është pasqyruar kostua repektive e kësaj shitje në vlerën 168,050,250 leke. Rezultati bruto nga ky veprim është fitimi në leke, $7\,479\,244 = 175,529,494 - 168,050,250$.

Taksat lokale të shpenzimeve të tjera që lidhen me biznesin janë llogaritur dhe pasqyruar në llogaritë e ushtrimit. Në postin shpenzime të tjera.

Sipas natyrës së tyre shpenzimet e ushtrimit 2014 janë treguar në pasqyrën përkatëse.

▪ **Të ardhurat dhe shpenzimet financiare.**

Jane paraqitur si diferencë e të ardhurave me shpenzimet sipas kërkesave të standarteve.

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Referencat Nr.llog.	Viti Raportues 31.12.2014	Viti Paraardhës 31.12.2013
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		-	-
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		-	-
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	19		
	12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata		-	-
	12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667		-	-
	12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669		-	-
	12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668		(984,267)	
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve finan (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)		(984,267)	-

-Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2014 jane si vijon:

Nr.	Përshkrimi I Elementëve	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2014	Viti Paraardhës 31.12.2013
I	FITIMI NETO PARA TATIMIT		46,248,216	24,276,559
II	SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)		984,268	62,201
1	Amortizime tej normave fiskale		0	0
2	Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor		0	0
3	Gjoha, penalitete, demshperblime		984,268	62,201
4	Provizione qe nuk njihen		0	0
5	Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta		0	0
6	Te tjera(interesa bankare mbi 1:4)		0	0
III	PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)		-	-
IV	FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)		47,232,484	24,338,760
V	Shpenzimi i tatim fitimit-10%		7,084,873	2,433,876
VI	FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)		39,163,343	21,842,683

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e me sipërme:

20.Numri mesatar i punonjesve dhe pagat sipas kategorite kryesore jane si me poshte :
Numri mesatar i punonjesve sipas kategorive per vitin 2014 eshte 45 punonjes.

Numri mesatar i punonjesve dhe pagat sipas kategorite kryesore jane si me poshte :

Kategorite	Ushtrimi 2014 (000 leke)			Ushtrimi 2013 (000 leke)		
	Numer mesatari	Paga	Sgurime punedhenesi	Numer mesatari	Paga	Sgurime punedhenesi
Administrator, menaxher	1	1,800	196	1	1,800	190
Specialist me arsim universitar Teknike	2	1,092	182	1	720	85
Puntor	42	3658	606	8	2043	372
Shuma	45	6,550	984	10	4,563	647

21.Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundeshme, jane kryer ne perputhje me formen ligjore te tyre , ne 31 Dhjetor 2014.

22.Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rëndesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

Nga analiza e gjendjes dhe Performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2014 kemi nje fitim prej 39,163,343 leke.

Ose me nje norme rentabiliteti neto/te ardhurave prej 10,3 %.

23. Shifrat krahasuese

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2014 eshte zbatuar formati i SKK-2, i cili eshte zbatuar edhe ne vitin paraardhes prandaj shifrat jane te krahasushme.

24. Vijushmeria e aktivitetit

Mendoj qe vijushmeria e biznesit eshte e garantuar edhe per vitin ne vazhdim .

Argumentuar kjo me;

- *Ka emer te mire per sherbimet cilesore qe afron.*
- *Ka gjendje kesh dhe kerkesa per te arketuar per te perballuar detyrimet .*
- *Per momentin nuk ka asnje konflikt gjygsor me kreditoret.*
- *Eshte korekte ne mardhenie me shtetin.*
- *Ka realizuar nje norme rentabiliteti shume te mire.*
- *Ka investuar ne aktivet afatgjate materjale.*
- *Ka rritje te kapitaleve te veta neto.*

Tirane me 17/03/2015

Auditoi pasqyrat financiare dhe shenimet per pasqyrat financiare, audite e pa varur:

Lumturi BRAHAJ

Eksperte Kontabel e Regjistruar

